

TRADITA KTHEHET NË THESAR KULTUROR

Prof. dr. Agron Xhagolli

Etnokultura e shqiptarëve, ndonëse hapësirat kohore dhe krahinore të regjistrimit i ka dukshëm të vona, ka qenë dhe është e mirëpranuar dhe joshëse për popullatat shqiptare kudo që kanë jetuar, por tashmë në përmasa që vijnë drejt një bjerrjeje. Kjo ka bërë të mundur që të ruhen deri në ditët tona, ndonëse gjithnjë e më pak, gjurmë dhe praktika të ndryshme. Dëshmi për këtë pohim është dhe puna e realizuar lidhur me dollinë, nga prof. dr. Sherif Bundo, një nga ekonomistët e njohur shqiptarë, brenda e jashtë vendit, por që është i ngacmuar, i tërhequr dhe me përkushtim për të ndjekur të gjithë këtë institucion, siç e përcakton vetë, institucionin e dollisë. Me pasion dhe dashuri, regjistrues rreth kësaj tradite ndër vite, si dhe i pranishëm e praktikues i dollisë, për herë të parë në tërësinë e etnokulturës shqiptare, profesori sjell një studim me përmasa të gjera, në formën jo klasike të një monografie shkencore, duke shprehur objekt të

punës së tij dollinë në zonat jugore dhe juglindore të Shqipërisë, ndonëse dollia praktikohet edhe në zona të tjera të Shqipërisë.

Edhe si e para punë e një përmase në nivele të tilla, bëhet e qartë për lexuesit se kemi të bëjmë me një punë mjaft të vlefshme, e zbërthyer në nënndarje të emërtuara sipas një skeme që ndjek dhe të sugjeron vetë dollia në tërësinë e vet.

Në këtë studim gjenden trajtesa rreth dollisë si një institucion që lartëson mikun, që respekton të ftuarit, flitet për mënyrën se si funksionon dollia (përfshirë këtu hierarkinë e pjesëmarrësve në sofër; si fillon dialogu; bashkëdrejtuesit e çdo sofere). Në vazhdim autori shtron, përcakton dhe parashtron objektin e punimit të tij, që është dollia e centralizuar ose autoritare (dollia e vjetër), duke sjellë edhe kufijtë e praktikimit të saj. Bën fjalë për të gjithë elementet e kësaj dollie, për instrumentet e realizimit të saj, si: *saku, gotat e rakisë, sofrat me meze* dhe “miku kërkon bukë”; mirëkuptimi për zgjatjen e dollive, për të vazhduar me përcaktimet e dollisë liberale ose dollinë e kohëve moderne. Për ta konkretizuar edhe më shumë, Prof. dr. Bundo nuk lë jashtë vëmendjes edhe elemente të tjerë të dollisë, vlerat dhe funksionet e tyre, si *dollibashi*, dhe *kryetari i sofrës* apo i odës; *sekretari i dollisë* dhe dollitë me dy sekretarë; *mirësia e dollisë*; kush mund të ngrëjë dollin; kodet e rakisë; shprehja “të paça”; teprimet në

dolli; “viktimat” e gostive; kuptimi i dy fjalëve “*të kam gjetur*”; ngritja e dollisë; “bromp”, si e barabartë me ftesë; saku, si shefi i protokollit; *numri i shëndeteve* të një dollie; cilat janë shëndetet, i pari dhe i fundit etj.

Pasi e pashë me interes të veçantë trajtesën rreth dollisë, mbeta i befasuar, jo vetëm nga mënyra e të shkruarit plot elegancë, frymëzim dhe dashuri për temën, por edhe se ajo përmbush kritere të mirëfillta shkencore, për nga mënyra e sjelljes së lëndës përkatëse.

Pa këtë vepër nuk do të ishte e mundur të spikaste, e thënë me plot gojën, kjo mënyrë përcjelljeje e jetesës së shqiptarëve nga brezi në brez, por ajo tashmë do të jetë e dëshmuar në një shpërfaqje shumë konkrete; punimi mund të jetë nxitje edhe për individë të tjerë pasionantë që të bëjnë të mundur regjistrimin dhe trajtimin e dollisë edhe në hapësira të tjera shqiptare, ku ajo vazhdon ende të jetojë në forma të ndryshme; me shumë interes do të ishin trajtesa të realizimit të dollisë, jo vetëm nga brezi i ri vendas, por edhe nga të huajt, si një mënyrë tërheqëse kjo për turizmin shqiptar. Besoj se nuk do ta teproja aspak nëse do të shprehesh, së fundi, se realizimi i këtij punimi nga ana e prof. dr. Sherif Bundos, jo vetëm më ka bërë shpresëplotë se është arritur një punim shumë i vlefshëm, por se ka krijuar një bazë shumë të rëndësishme për të pasur vazhdimësi për trajtime

edhe më të zgjeruara, për të përmbushur kërkesat që ka UNESCO në shpalljen edhe të *Dollisë shqiptare* si pjesë e trashëgimisë kulturore botërore. Shpresoj që kjo dëshirë e imja të kthehet në një realitet sa më shpejt që të jetë e mundur. Ndaj i uroj Prof. dr. Sherif Bundos që me punën e tij ngulmuese të jetë dhe pasuruesi i vlerave të traditës kombëtare shqiptare si pasuri botërore, për një mbrojtje edhe nga organizmi mjaft i rëndësishëm ndërkombëtar, siç është UNESCO.